

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga shoqëria Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia shoqëri aksionare Beograd me seli të regjistruar në rrugën Takovska nr. 2, Beograd, Republika e Serbisë, përmes personit të autorizuar Ognjen Trajkovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 12.03.2025, mori

AKTVENDIM

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia shoqëri aksionare Beograd me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, do të fitojë kontroll individual, gjegjësisht të drejtën e pronësisë mbi një pjesë të operacionit, gjegjësisht mbi infrastrukturën e SKJNET KTV SHPK Zlatibor, Republika e Serbisë, me seli të regjistruar në rrugën dr. Dragosllav Zeke Smiljancica bb, 31215 Zlatibor, Republika e Serbisë, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të rezultojë me pengim, kufizim ose prishje të rëndësishme të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozicionit dominues të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptimin e nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftim për përqendrim në shumën prej 6,000.00 denarë dhe për vendimin në shumën prej 30,000.00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksat administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi i të ardhurave dhe programi 72231300.

3.Padia për fillimin e kontestit administrativ nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Ligji), më 11.02.2025, dhe plotësuar më 20.02.2025 dhe 26.02.2025, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), i është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ana e Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia shoqëri aksionare Beograd", me seli të regjistruar në rrugën Takovska numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, me të cilën Ndërmarrja për telekomunikacion Telekom Serbia shoqëria aksionare Beograd do të fitojë kontroll individual, gjegjësisht të drejtën e pronësisë mbi një pjesë të operacionit, gjegjësisht mbi infrastrukturën e SKJNET KTV SHPK Zlatibor, Republika e Serbisë, me seli të regjistruar në rrugën dr. Dragosllava Zeke Smilaniça pn, 31215 Zlatibor, Republika e Serbisë.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim, plotësimin dhe shtojcat e tij, konstatoi sa vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të prekura:

-Ndërmarrja për telekomunikacion "Telekom Serbia" shoqëri aksionare Beograd është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikacion kabllor, dhe nga shërbimet që ofron, veçojmë shërbimet për telefoni fikse dhe mobile, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

Ndërmarrja për telekomunikacion "Telekom Serbia" shoqëri aksionare Beograd ka një person të lidhur¹ në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe kjo është: **Shoqëria për tregti dhe shërbime "MTEL SHPKNJP Shkup"**, selia e të cilit është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e regjistruar për veprimtari: telekomunikacion me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve vijuese: rrjet publik radio-komunikues, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër operatoresh, shërbime telefonike të disponueshme publikisht në rrjetin publik të komunikimeve mobile, ri-transmetim i shërbimeve programore televizive, satelit.

Shoqëria për tregti dhe shërbime "MTEL SHPKNJP Shkup" ka një person të lidhur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe kjo është: **Shoqëria për telekomunikacion LAJKAMOBAL SHPKNJP Shkup me seli** të regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër. Shoqëria për telekomunikacion LAJKAMOBAL SHPKNJP Shkup operon në tregun për ofrimin e shërbimeve mobile të komunikimeve elektronike (shërbim me parapagesë) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj përfundimtar shërbim mobil postpaid. Shoqëria për telekomunikacion LAJKAMOBAL SHPKNJP Shkup është operator i rrjetit virtual mobil (OVRM) në tregun e Maqedonisë për komunikime elektronike dhe ofron shërbime kombëtare, ndërkombëtare dhe roaming për thirrje zanore, SMS dhe internet.

-SKJNET KTV, SHPK Zlatibor është operator i shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, i regjistruar për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse në internet me brez të gjerë, tregu me pakicë për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjes mediatike në territorin e Republikës së Serbisë.

SKJNET KTV, SHPK Zlatibor nuk ka persona juridikë të lidhur dhe nuk ka realizuar të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose çrregullimin e ndjeshëm të konkurrencës

¹ Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës me vendimin nr. 08-31/2023 të datës 22.03.2023 miratoi përqendrimin me të cilin MTEL SHPKNJP Shkup me seli të regjistruar në rrugën Maksim Gorki nr. 11-1/kat 3, 1000 Shkup, do të fitojë kontroll mbi shoqërinë NEOTEL SHPK Shkup, me seli në bulevardin Kuzman Josifovski-Pitu nr. 15, 1000 Shkup.

efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Sipas nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative brenda 30 ditëve nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE

Mr. Малинка Силјановска Николиќ